



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1200/23 Data: 15/09/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohe/riakreditohe programet e studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor:
- Inzhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R;*
 - Inzhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A).*
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT kampusi kryesor, ka parashtruar kërkesë Nr.Prot.1880/22 e datës 31.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA), për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimeve:

- Inzhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R;*
- Inzhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A).*

Pas aprovimit të aplikacionit, IAL ishte informuar nga AKA për vazhdimin e procedurave të akreditimit/riakreditimit të programeve sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22).

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik dhe ekspertët si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inzhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R;</i>	Valdrin Haxhiu Diellza Berisha Vesa Morina Zhilbert Tafa Lavdim Menxhiqi
2.	<i>Inzhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A).</i>	Sami Gashi Gazmend Krasniqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R*; vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje; Francisco Javier Farfan dhe Lali Giorgitze është organizuar me 13.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) Substancialisht, tre (3) dhe Pjesërisht tre (3) standarde.
2. Për programin e studimit; *Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje; Francisco Javier Farfan dhe Lali Giorgitze është organizuar me 14.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht tre (3) standarde.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, ka shqyrtuar raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit të dalura nga vizitat e realizuara në terren, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, në të cilin raport Infrastruktura dhe Resurset janë plotësuar pjesërisht nga Kolegji UBT kampusi kryesor.

Bazuar në këtë raport të cekur më lartë, referuar Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), ku në paragrafin II të vendimit për plotësim/ndryshimin e manualit i cili më pas është bërë pjesë përbërëse e manualit, thuhet, citojmë: *"Në standardet e vlerësimit për programet e studimit në nivel Bachelor dhe Master, Kapitulli 2, nënkapitulli 2.2 paragrafi 3, i cili i referohet Stafit akademik, dhe paragrafi 7 i cili i referohet Infrastrukturs dhe pajisjeve, janë obligativ. Programet e studimit në nivel Bachelor apo Master nuk mund të rekomandohen për akreditim derisa nuk kanë përmbushur në mënyrë substanciale apo të plotë të dy këto fusha të përgjithshme."*

Gjatë vlerësimit, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit në raport kanë konstatuar se fushën e standardeve obligative që i referohet Infrastrukturs dhe pajisjeve, Kolegji UBT kampusi kryesor përmbushë vetëm pjesërisht, e që sipas manualit përmbushja e fushave të tjera nuk mjafton për akreditimin e programit.

Andaj bazuar në dispozitat ligjore dhe raportet e ekspertëve të cekura më lartë KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrij ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetërorë të Cilësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1200/23 Data: 15/09/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohen/riakreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor:
- Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R;*
 - Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A).*
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT kampusi kryesor, ka parashtruar kërkesë Nr.Prot.1880/22 e datës 31.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA), për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimeve:

- Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R;*
- Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A).*

Pas aprovimit të aplikacionit, IAL ishte informuar nga AKA për vazhdimin e procedurave të akreditimit/riakreditimit të programeve sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22).

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik dhe ekspertët si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R;</i>	Valdrin Haxhiu Diellza Berisha Vesa Morina Zhilbert Tafa Lavdim Menxhiqi
2.	<i>Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A).</i>	Sami Gashi Gazmend Krasniqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Bachelor Professional, niveli 5, 120 ECTS, R*; vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje; Francisco Javier Farfan dhe Lali Giorgitze është organizuar me 13.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) Substancialisht, tre (3) dhe Pjesërisht tre (3) standarde.
2. Për programin e studimit; *Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS, (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje; Francisco Javier Farfan dhe Lali Giorgitze është organizuar me 14.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht tre (3) standarde.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, ka shqyrtuar raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit të dalura nga vizitat e realizuara në terren, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, në të cilin raport Infrastruktura dhe Resurset janë plotësuar pjesërisht nga Kolegji UBT kampusi kryesor.

Bazuar në këtë raport të cekur më lartë, referuar Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), ku në paragrafin II të vendimit për plotësim/ndryshimin e manualit i cili më pas është bërë pjesë përbërëse e manualit, thuhet, citojmë: *"Në standardet e vlerësimit për programet e studimit në nivel Bachelor dhe Master, Kapitulli 2, nënkapitulli 2.2 paragrafi 3, i cili i referohet Stafit akademik, dhe paragrafi 7 i cili i referohet Infrastrukturës dhe pajisjeve, janë obligativ. Programet e studimit në nivel Bachelor apo Master nuk mund të rekomandohen për akreditim derisa nuk kanë përmbushur në mënyrë substanciale apo të plotë të dy këto fusha të përgjithshme."*

Gjatë vlerësimit, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit në raport kanë konstatuar se fushën e standardeve obligative që i referohet Infrastrukturës dhe pajisjeve, Kolegji UBT kampusi kryesor përmbushë vetëm pjesërisht, e që sipas manualit përmbushja e fushave të tjera nuk mjafton për akreditimin e programit.

Andaj bazuar në dispozitat ligjore dhe raportet e ekspertëve të cekura më lartë KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrij ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

